



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 6 prill 2011  
Nr. ref.: 89/11

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin Nr. KI 55/09**

Parashtruesi

**NTSH Meteorit**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit Nr. 2407/2006 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 30 shtatorit 2009**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është NTSH Meteorit me seli në Prizren, përmes pronarit të vet Tahir Hoxha nga Prizreni, i përfaqësuar nga Sahit Bibaj, avokat, gjithashtu nga Prizreni.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 2407/2006, i 30 shtatorit 2009.

## **Baza juridike**

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe Rregullit 57 (1) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

4. Parashtruesi i kërkesës parashtror një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me të cilën kërkonte shfuqizimin dhe anulimin e Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 2407/2006, të 30 shtatorit 2009, si shkelje të së drejtës së vet kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç përshkruhet në nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për shkak të dështimit të Gjykatës Supreme për ta anuluar Vendimin e Bordit të Pavarur Shqyrtues (BPSH), A. nr. 439/2006, të 24 gushtit 2006, lidhur me detyrimet tatimore të parashtruesit të kërkesës.
5. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy, kryesues, Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për pranueshmëri të kërkesës. Gjykata në përbërje të plotë këshilloi dhe votoi në seancë të mbyllur për këtë kërkesë më 13 dhjetor 2010.

## **Përmbledhje e fakteve**

6. Prej 1 shtatorit 2003 deri më 8 tetor 2003, zyrtarët e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) bënë kontrollimin e llogarive dhe të çështjeve tatimore dhe të fitimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me deklaratat tatimore dhe pagesat e tatimeve për periudhën 2000/2003. Në raportin e vet, të nxjerrë më 8 maj 2003, ATK-ja gjeti që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte deklaruar drejt qarkullimin e mallrave për qëllime tatimore, prandaj vlerësoi tatimet përkatëse, ndëshkimet dhe kamatat. Veçanërisht, bazuar në parregullsitë në librat e kontabilitetit të parashtruesit të kërkesës lidhur me të hyrat e blerjes, të hyrat e shitjes, dhe të tatimit në fitim të deklaruar për mallra të caktuar, ATK-ja përdori periudhën 60-ditore të skadimit të mallit për ta llogaritur qarkullimin e saktë për periudhën kohore në fjalë. Raporti përmbante tabela të hollësishme të metodave të kontabilitetit, të përdorura në vlerësimin e tatimit nga ATK-ja në bazë të sasisë fizike të stokut të mallrave të parashtruesit të kërkesës dhe të qarkullimit të deklaruar.
7. Parashtruesi i kërkesës fillimisht ushtroi ankesë në Departamentin për Ankesa të Administratës Tatimore kundër gjetjeve të ATK-së. Pas shqyrtimit të informatave të parashtruesit të kërkesës dhe krahasimit të tyre me faktet e ofruara nga Administrata Tatimore, Departamenti për Ankesa nxori Vendimin Nr. 426 më 9 janar 2004 dhe e hodhi poshtë ankesën.
8. Parashtruesi i kërkesës më pas parashtror ankesë në Bordin e Pavarur Shqyrtues (BPSH). BPSH-ja e shqyrtoi këtë rast dhe më 14 prill 2004, në pajtim me Rregulloren për Administratën dhe Procedurat Tatimore, Bordi Shqyrtues nxori Vendimin Nr. 62/2004, me të cilin e hodhi poshtë ankesën e Meteoritit si të pabazuar. BPSH, ndër të tjera, në vendimin e vet tha:

*Gjatë zhvillimit të biznesit të vet, NTSH Meteorit nuk u ishte përmbajtur rregulloreve dhe procedurave të tatimeve dhe udhëzimeve të inspektorëve tatimorë. Dokumentacioni i paraqitur në seancë, që ishte element kryesor i kontrollit ... dëshmon se taksapaguesi i kishte fshehur të ardhurat e veta.*

*Llogaritja e tatimit shtesë në të ardhura është bërë duke e krahasuar tatimin e deklaruar me qarkullimin real në bazë të shënimeve të taksapaguesit, intervistat dhe deklaratat paraprake të taksapaguesit për periudhën e kontestuar kohore, veprimtaritë e inspektorëve nëpërmjet inspektimit të tërthortë të biznesit dhe informatave nga palët e treta. Të dhënat e paraqitura në seancë ishin analizuar dhe krahasuar me të dhënat e marra nga Birraria e Pejës. Është përcaktuar që inspektori tatimor ka vepruar drejt dhe e ka zbatuar metodën [e drejtë] të analizimit të furnizimit dhe të shitjeve të deklaruara në lidhje me kronologjinë e datës së përdorimit.*

*Librat e shitjes dhe të blerjes nuk janë mbajtur në përputhje me Rregulloren.*

9. Më pas, parashtuesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme me të cilën kërkonte anulimin e vendimeve të Departamentit të Ankesave dhe të BPSH-së. Në ankesë pretendohet që metodat e kontabilitetit të ATK-së, duke përdorur periudhën e skadimit të birrës prej gjashtëdhjetë (60) ditësh për qëllime të qarkullimit pa ndonjë dëshmi të shitjes aktuale të stokut, padrejtësisht e kishin ngarkuar parashtuesin e kërkesës dy herë me detyrime tatimore. Parashtuesi i kërkesës dorëzoi një letër nga NP "Birraria" Pejë, në të cilën ofronte të dhëna të hollësishme se po të ishte ruajtur birra e Pejës në kushte optimale, ajo mund të shërbehej edhe pas skadimit të fatit të përdorimit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Megjithatë, letra nuk ofronte hollësi se sa kohë pas datës së skadimit birra mund të ruhej dhe shërbehej.
10. Më 17 maj 2006, Gjykata Supreme nxori Vendimin A. nr. 233/2004 në favor të parashtuesit të kërkesës "për ta miratuar kërkesëpadinë" dhe "anuluar vendimin e Bordit të Pavarur Shqyrtues", të 14 prillit 2004. Në vendim thuhej që BPSH-ja "nuk u ishte përmbajtur rregullave të procedurës për tatime dhe udhëzimeve të inspektorëve tatimorë" për shkak të dështimit të vet për t'iu referuar rregullave dhe rregulloreve specifike që parashtuesi i kërkesës kishte dështuar t'i respektonte në regjistrat e tij. Përveç kësaj, Gjykata Supreme vendosi që BPSH-ja dështoi të ofronte arsye të mjaftueshme lidhur me "bazën juridike të obligimit tatimor, llojin, shumën dhe kohën e shlyerjes së obligimit tatimor, që janë të dhëna të rëndësishme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje administrative". Gjykata Supreme urdhëroi rigjykim të çështjes për t'i trajtuar mangësitë në regjistër.
11. Në përputhje me vendimin e Gjykatës Supreme, BPSH-ja mbajti edhe një seancë tjetër më 28 korrik 2006. Pas dëgjimit të meritave të rastit, BPSH-ja nxori vendimin e vet të ri, A. nr. 439/2006, të 24 gushtit 2006, me të cilin e hidhte poshtë ankesën. Në vendimin e vet, BPSH-ja analizoi dëshmitë e paraqitura nga parashtuesi i kërkesës, ankesën me shkrim, dëshmitë e paraqitura në seancë, dhe "shqyrtoi dëshmitë e paraqitura nga të dy palët". BPSH-ja vendosi që parashtuesi i kërkesës "nuk e kishte paraqitur qarkullimin real dhe i kishte zvogëluar deklaratat në kategorinë e tatimit të paragjykuar për ... periudhën [e kontrollimit]". Të gjitha dëshmitë e paraqitura nga palët në seancë u analizuan dhe krahasuan me informatat e marra nga Birraria e Pejës. Kjo analizë rezultoi në përcaktimin që inspektori tatimor kishte vepruar drejt dhe e kishte zbatuar "metodën e analizës së furnizimit dhe shitjeve të deklaruara" lidhur me datat e skadimit të mallit në fjalë për raportin e kontrollimit. Përveç kësaj, BPSH-ja vendosi që librat e blerjes dhe të shitjes të parashtuesit të kërkesës nuk ishin mbajtur në përputhje me rregulloren, gjë që

rezultoi në një gjobë prej 125 eurove më 2 qershor 2004, dhe që rivlerësimi i tatimit të llogaritur dhe gjobat ishin të vlefshme.

12. Parashtruesi i kërkesës më pas ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të BPSH-së A. nr. 439/2006. Parashtruesi i kërkesës theksoi në ankesë se të dy palët në ankesë kishin paraqitur sqarime shtesë lidhur me faktet. Parashtruesi i kërkesës pohoi që i kishte përmbushur të gjitha obligimet e parapara me rregullore dhe dispozita të tjera ligjore, siç u dëshmua nga dokumentacioni dhe dëshmitë e përfshira në dosje. Parashtruesi i kërkesës vazhdoi të pohonte që vlerësimi i tatimit nuk ishte i drejtë.
13. Në Vendimin A. nr. 2407/2006, të 30 shtatorit 2009, Gjykata Supreme e hodhi poshtë këtë ankesë si të pabazuar. Gjykata Supreme vendosi që BPSH-ja "e kishte ndjekur formën [e kërkuar ligjore] të përcaktuar në nenin 206 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), pjesa hyrëse e vendimit [të BPSH-së] ishte hartuar në përputhje me nenin 207, paragrafin 1 të LPPA-së, dhe arsyetimi ishte në përputhje me nenin 209, paragrafin 2 të LPPA-së". Gjykata Supreme vendosi që rigjykimi i BPSH-së i shqyrtoi dëshmitë e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, përfaqësuesi i ATK-së, dëshmitë e parashtruara në seancë, dhe dosjen kur BPSH-ja miratoi konkluzionin e vendimit fillestar të BPSH-së Nr. 62/2004, të 14 prillit 2004. Përveç kësaj, Gjykata Supreme vendosi që BPSH-ja e kishte respektuar rregulloren e punës, gjendjen faktike, dhe kishte paraqitur dëshmi kur "kishte vendosur që parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje tatimore", për të cilat i ishte shqiptuar gjoja dhe kamata. Në bazë të këtij vendimi të formës së prerë të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 19 tetor 2009.

### **Pranueshmëria**

14. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

dhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili thotë:

*Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

15. Është e qartë që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, brenda afatit ligjor, para se ta parashtronte kërkesën e vet. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu saktëson cilat të drejta dhe liri i janë shkelur, duke treguar aktin konkret të autoritetit publik të cilin e konteston; dhe e arsyeton kërkesën duke i bashkëngjitur informatat e domosdoshme mbështetëse dhe dokumentacionin. Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa është e pranueshme.

### **Meritat**

#### **E drejta për gjykim të drejtë**

16. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është një prej tipareve kryesore të një shteti të bazuar në sundim të ligjit. Ajo e drejtë është e përfshirë në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (Konventa). Neni 31 i

Kushtetutës së Kosovës parashikon të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me sa vijon:

**Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
  3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
  4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
  5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
  6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
  7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.
17. Neni 6.1 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, që ishte i përfshirë në Ligjin e Kosovës, në pajtim me dispozitat e nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës parashikon me sa vijon:

*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

18. Me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit të Bordit të Pavarur Shqyrtues dhe të Gjykatës Supreme, Gjykatës Kushtetuese i lejohe të shqyrtojë vetëm nëse ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesit të kërkesës. Prandaj, Gjykata Kushtetuese mund të ndërhyjë vetëm në rast të shkeljes së ndonjë të drejte themelore specifike të mbrojtur me të drejtën kushtetuese. Nëse nuk është shkelur asnjë e drejtë themelore, Gjykata Kushtetuese duhet t'i përmbahet vendimit të Gjykatës Supreme
19. Me këtë rast, parashtruesit të kërkesës i ishte mundësuar seanca dëgjimore nga Bordi i Pavarur Shqyrtues, me ç'rast përfaqësuesit e Administratës Tatimore ishin dëgjuar, dëshmitë ishin paraqitur, dhe marrja në pyetje ishte lejuar. Pas kësaj, Bordi i Pavarur Shqyrtues gjeti që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte paraqitur qarkullimin e vërtetë dhe që i kishte zvogëluar deklaratat për periudhën përkatëse tatimore. Në parim, parashtruesit të kërkesës nuk i ishte besuar lidhur me dëshmitë që i kishte paraqitur. Bordi veproi në kuadër të kompetencave të veta për të arritur në atë konkluzion.

20. Në vendimin e vet të dytë, Gjykata Supreme e shqyrtoi vendimin e dytë të Bordit të Pavarur Shqyrtues dhe argumentet e përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës. Ajo vuri në pah se Bordi i Pavarur Shqyrtues kishte konkluduar pas seancës dëgjimore se nuk kishte dyshim që parashtruesi i kërkesës i kishte shkelur dispozitat tatimore. Gjykata ishte e kënaqur që forma e vendimit ishte e drejtë dhe ishin respektuar kushtet e ligjeve tatimore dhe arsyetimi.
21. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që ta vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të nxjerra nga institucionet kompetente gjyqësore, nëse nuk ka prova që vendimet e tilla janë nxjerrë në mënyrë të padrejtë dhe të pasaktë.
22. Detyra e Gjykatës për t'iu përkrahur me shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese është të shqyrtojë nëse procedurat, të marra si tërësi, kanë qenë të drejta dhe nëse janë respektuar garancitë specifike të përcaktuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk është e shkallës së katërt të apelit, dhe nuk ka juridiksion t'i rihapë procedurat gjyqësore apo t'i zëvendësojë vendimet e gjykatave të rregullta me gjetjet e veta. Siç është theksuar nga kjo Gjykatë në rastin e Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, të 19 majit 2010, rasti 07/09, dhe në rastin e X të 17 qershorit 2010, rasti Nr. KI 06/09, "Fakti i thjeshtë që parashtruesi/parashtruesit është i/janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* Aktgjykim, GJEDNJ, kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005.)"
23. Nuk ka dëshmi në këtë rast që Gjykata Supreme i ka vlerësuar dëshmitë e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në mënyrë të padrejtë apo të pasaktë. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të dëshmonte që Gjykata Supreme e ka shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe nenin 31 të Kushtetutës.
24. Duke marrë parasysh arsyetimin e përcaktuar më lart dhe gjetjet e Bordit të Pavarur Shqyrtues dhe të Gjykatës Supreme, Gjykata Kushtetuese konstaton që nuk ka pasur shkelje të së drejtës për dëgjim të drejtë dhe nuk ka pasur shkelje të të drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, siç parashihet në nenin 6.1 të Konventës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, me shumicë votash

## VENDOS


- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme.
- II. Që nuk ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari Raportues**

  
Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. Dr. Enver Hasani